



# Buletini Mjedisor

## 27 JANARI—DITA KOMBËTARE E SHËRBIMIT PYJOR SHQIPTAR



27 Janari është shpallur Dita e Shërbimit PyJOR Shqiptar, në kujtim të datës 27 janar të vitit 1923 kur u miratua “Ligji i parë shqiptar i pyjeve dhe kullosave”.

Në kuadër të kësaj dite, Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, zhvilloi një takim me akademikë dhe specialistë të Fakultetit të Shkencave Pyjore në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Në këtë takim u diskutua, jo vetëm për arritjet, por edhe për problematikat që hasen sot në fushën e pyjeve. Një nga shqetësimet kryesore që ju prezantua Ministrit të Mjedisit nga ekspertët e pyjeve, që janë pjesë

akademike e këtij univeristet, ishte dhe sëmundja e njohur e pishave, procesionarja. Pasi u diskutua me këta ekspertë të pyjeve, z. Koka u zotua se do të merrte masa për ta zgjidhur këtë problem.

Gjatë këtij aktiviteti z. Koka shpërndaui dhe certifikata mirënjohje për inxhinierë të pyjeve dhe punonjësit e shërbimit pyJOR, që kanë shërbyer me përkushtim ndër vite.

Kjo ditë e rëndësishme u mbyll me mbjelljen e fidanëve në Parkun Botanik të Fakultetit të

Shkencave Pyjore.

Parku Botanik do të shtrihet në të gjithë kampusin universitar duke zënë një sipërfaqe prej rreth 83 mijë metër katror, në pjesën jug-perëndimore të godinës së rektoratit të UBT. Këtu do të mbillen 10 mijë fidanë, 50 lloje specimesh drusore në blloqe me nga 200 fidanë për secilin lloj.

Parku Botanik do të shërbejë si një oaz qetësie dhe çlodhjeje, por edhe si bazë eksperimentale për studentët e këtij universiteti.

Nga ky park do përfitojnë edhe banorët e zonës.

## MINISTRIA E MJEDISIT- BILANCI I PUNËS NË KËTË VIT KALENDARIK

Në çdo fund vit, çdo institucion bën bilancin e punës së bërë gjatë vitit dhe vendosjen e objektivave për vitin në vazhdim. Këtë gjë ka bërë dhe Ministria e Mjedisit duke parë të gjithë problematikat arritshmëritë dhe detyrat që dalin për vitin në vazhdim. Me Ju do donim të ndanim disa nga arritjet e Ministrisë së Mjedisit gjatë vitit 2014, arritje të cilat do shërbejnë për ecurinë e mëtejshme në fushën e mbrojtjes së Mjedisit.

Gjatë vitit 2014 matrica vjetore e **Akteve Ligjore** të Ministrisë së Mjedisit, përfshinte hartimin dhe miratimin e rreth 39 akteve ligjore. Në bilancin e bërë në fundvit vihej re se janë përfunduar mbi 40 akte. Shumica e tyre është miratuara, disa kanë përfunduar së hartuari por janë në proces miratimi.

Në fushën e **Biodiversitetit** dhe Zonave të Mbrojtura gjatë 2014 u hartua dhe hyri në fuqi në mars 2014, Moratoriumi për Gjuetinë për një periudhë 2 vjeçare, 2014 – 2016.

U shpall Parku Natyror Rajonal “Nikaj-Mërtur”, duke e çuar sipërfa-

qen e zonave të mbrojtura (tokësore dhe detare) nga 16% të territorit të Republikës së Shqipërisë në janar 2014 në 16.61%, në Dhjetor 2014. Po gjatë vitit 2014 është punuar për shpalljen e parkut Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”, i cili pritet të përfundoj në 2015, duke e çuar sipërfaqen e zonave të mbrojtura në 19 % të territorit të vendit.

Por në 2015 do i jepet përparësi mbrojtjes dhe kthimit në identitet të këtyre zonave të mbrojtura. Kjo mund të realizohet vetëm nëpërmjet miratimit të plan menaxhimit të këtyre zonave. Gjatë 2014 janë miratuar 6 plane menaxhimi të zonave të mbrojtura, dy të tjera janë në fazën e përfundimit dhe një është në proces konsultimi dhe miratimi. Një tjetër akt i rëndësishëm ligjor gjatë vitit 2014 në fushën e mbrojtjes së biodiversitetit është edhe hartimi dhe miratimi i VKM-së 272, datë 07.05.2014 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e qendrave të shpëtimit të llojeve të faunës së egër”.

Në fushën e Pyjeve, po hartohet

Ligji i Ri të Pyjeve, i cili pritet të miratohet në fillim të vitit 2015. Po gjatë vitit 2014 u bë riorganizimi i shërbimit pyJOR në drejtori rajonale, me qëllim ndarjen e funksioneve menaxhuese nga ato kontrolluese, si një detyrim ligjor që nuk kishte gjetur zbatim që prej vitit 2005.

Viti i kaluar ka vërejtur një rritje të ndjeshme të investimeve nga buxheti i Ministrisë së Mjedisit në fushën e pyjeve dhe zonave të mbrojtura. Në total janë 8 projektet pyllëzimi apo përmirësimi të infrastrukturës në zonat e mbrojtura dhe parqet kombëtare, me vlerë: 442,079,926 Lekë, si edhe 80,000,000 lekë të tjera të alokuara disa komunave në vend nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit për projekte pyllëzimi.

Me qëllim ndërtimin institucional dhe forcimin e kapaciteteve inspektuese dhe monitoruese, Ministria e Mjedisit arriti ndarjen e menaxhimit nga kontrolli.

(vijon në fq 3)

### NË KËTË NUMËR:

27 JANARI—DITA KOMBËTARE E SHËRBIMIT PYJOR SHQIPTAR 101

MINISTRIA E MJEDISIT- BILANCI I PUNËS NË KËTË VIT KALENDARIK 102

LEJDET MJEDISORE JANAR 2015 103

VAZHDIMË TRANSMITIMET STRUKTURALE E VARSIVË NË PREFEKTURAT E VENDIT 104

*“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit, dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Europian. Përmesja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, xituar dhe bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik”.*

## LEJET MJEDISORE JANAR 2015

Nr	EMRI I SUBJEKTTIT	AKTIVITETI	VENDODHJA E AKTIVITETIT	VENDIMI	LLOJI I LEJES
1.	EURO ADITIV	PRODHIMI I KIMIKATEVE ORGANIKE BAZË	VORË KM 16	MIRATIM	TIPI A
2.	ZOTO-ZZ	NXJERRJA E MINERALEVE, RËRËS DHE ARGJILËS NGA MINIERAT ME SHFRYTËZIM NË QIELL TË HAPUR DHE NGA GURORËT	VLORË	MIRATIM	TIPI B
3.	ZOTO-ZZ (LC-9275)	NXJERRJA E MINERALEVE, RËRËS DHE ARGJILËS NGA MINIERAT ME SHFRYTËZIM NË QIELL TË HAPUR DHE NGA GURORËT	BASHKIA HIMARË, QARKU VLORË	MIRATIM	TIPI B
4.	AURORA LINE	SHKRIRJA DHE PËRFITIMI I ALIAZHEVE TË METALEVE JOFERROSE (ME NGJYRË) PËRFSHIRË PRODUKTET E RIKUPERUARA	TIRANË	MIRATIM	TIPI B
5.	SAN LEON DURRËSI B.V	KËRKIM I NAFTËS DHE GAZIT NATYROR	DURRËS	MIRATIM	TIPI A
6.	SARDA-GRUP	III.2.B GRUMBULLIM, PËRPUNIM, RIKIKLIM DHE ASGJËSIM I MBETJEVE URBANE, SPITALORE, ORGANIKE, KIMIKE DHE BAKTERIOLOGJIKE	LEZHË	REFUZIM	TIPI B
7.	G.I.B	PËR PËRZIERJEN E ÇIMENTOS OSE PËRDORIMI I ÇIMENTOS OSE PËRDORIMI I ÇIMENTOS NË MASË TË MADHE, POR JO NË SHESHIN E NDËRTIMIT, PËRFSHIRË AMBALAZHIMIN DHE PËRZIERJEN E ÇIMENTOS, GRUMBULLIMI I BETONIT DHE BLOQVEVE TË BETONIT DHE PRODUKTEVE TË TJERA TË ÇIMENTOS	KUKËS	MIRATIM	TIPI B
8.	ELAMI	PRODHIM I PRODUKTEVE ABRAZIVE DHE PRODUKTEVE TË TJERA MINERALE JOMETALIKE	DIBËR	MIRATIM	TIPI B
9.	SHKËLQIMI 07 (LC-9414)	VEPRIMTARITË QË NUK PËRFSHIHEN NË PIKAT 7.3 A OSE 7.3 B OSE PIKA TË TJERA TË KËSAJ SHTOJCE, QË PËRFSHIJNË NGROHJEN, POR JO DISTILIMIN E KATRANIT OSE BITUMIT NË LIDHJE ME NDOJË VEPRIMTARI PRODHIMI	PORTËZ, FIER	MIRATIM	TIPI B
10.	SHKËLQIMI 07 (LC-9416) S	PËR PËRZIERJEN E ÇIMENTOS OSE PËRDORIMI I ÇIMENTOS OSE PËRDORIMI I ÇIMENTOS NË MASË TË MADHE, POR JO NË SHESHIN E NDËRTIMIT, PËRFSHIRË AMBALAZHIMIN DHE PËRZIERJEN E ÇIMENTOS, GRUMBULLIMI I BETONIT DHE PRODUKTEVE TË TJERA TË ÇIMENTOS	PORTËZ, FIER	MIRATIM	TIPI B
11	ARIS ALBANIA	NDRYSHIM	BULQIZË, DIBËR	MIRATIM	TIPI B
12	ZASHA	NDRYSHIM	BULQIZË, DIBËR	MIRATIM	TIPI B

## VAZHDOJNË TRAJNIMET ME STRUKTURAT E VARËSIVE NË PREFEKTURAT E VENDIT



Vazhdojnë trajnimet që në këtë takim pati përfaqësues nga ARM dhe Ministria e Mjedisit dhe Energjitikës për stafet e ndërmerrësve të varësisë ARM, ISHMPU rajonale, si dhe ekspertet mjedisore.

Deri tani janë zhvilluar takimet në Prefekturat e Lezhës, Durrësit, Tiranës, Beratit, Shkodrës, Elbasan, Fier.

Takimi i radhës u zhvilluan , më 27 Janar 2015 në prefekturën e Beratit. Takimi u hap nga Drejtori i Drejtorisë së Mjedisit z. Redi Baduni, i cili i konsideroi si mjaft të nevojshme këto trajnime që po ndërmerren në të gjithë vendin në kuadër të programit të 300 ditëshit, pasi do të ndihmojnë në punën e tyre ARM, ISHMPU rajonale, ekspertet mjedisore dhe bizneset në lidhje me procedurat e VNM dhe lejeve të mjedisit si dhe me legjislacionin e ri të miratuar për këto fusha.

Në këtë takim pati përfaqësues nga ARM dhe ISHMPU-ja e qytetit të Lezhës. Në këtë trajnim pati gjithashtu dhe prezencë nga pushteti vendor i Bashkisë së Rrëshenit, Rubikut dhe Laçit.

Pas fjalëve hapëse, përfaqësueset e Ministrisë së Mjedisit, znj. Ornela Shoshi dhe znj. Edlira Dersha, ju prezantuan të pranishmeve procedurat për t'u pajisur me Leje Mjedisore për aktivitetet që kanë ndikim mjedisor, rolin e këtyre strukturave në vendimmarrjen mjedisore. Modulet e prezantuara janë me tematikat e mëposhtme:

Zbatimin e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM);

Zbatimin e legjislacionit në fuqi për Lejet e Mjedisit;

Forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional për zbatimin e Konventës ESPOO (Për miratimin e rregullave dhe procedurës përvlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar-ESPOO)

Procedurat e konsultimit ndërinstytucional dhe me publikun gjatë zhvillimit të procesit të VNM-së dhe ESPOO-s

Në këtë trajnim pati një pjesëmarrje aktive, sidomos në lidhje me procedurat për t'u pajisur me leje mjedisore për aktivitetet që kanë ndikim mjedisor. Shumë të interesuar qenë dhe përfaqësuesit e Pushtetit vendor të Bashkisë Berat dhe Ura Vajgurore, në lidhje me kontrollet që duhet të vijojnë pas dhënies së Lejeve Mjedisore.

## VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS JANAR 2015

	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
		VNM-P - MBARËSHITIM I FAUNËS SË EGËR		
1	SOLOMON KON-STRUKSION	(THËLLËZË Ë FUSHËS)	PYLLI I HAJLERIT, LEVAN, FIER PATOS FSHAT, FIER ZONA	VNM-PARAPRAKE
2	BEJLERI ALFA	VNM-TH SHFRYTËZIM I RËRËS BITUMINOZE, VNM-P- NYJE FRAKSIONIMI DHE LARJE	KONKURRUESE 802/5	DEKLARATË MJEDISORE
3	BAJRAMI N	INERTESH LINJË PRODHIMI INERTESH,	XIBRAKË, LABBINOT,	REFUZIM VENDIM PËR VNM-
4	MP ENERGY	VNM- P HIDROCENTRAL, LEFTER 1,2,3	LESKOVIT, KOLONJË, KORÇË	THELLUAR
5	DEVOLL HYDROPOWER	VNM-TH RRUGA BANJË-GRAMSH URA E TRASHOVICËS	BANJE-GRAMSH, PISHAJ,	DEKLARATË MJEDISORE
6	GSM KLIMAIRE	VNM-P , NDERTIM KAPANONI INDUSTRIAL,	YRSHEK, KASHAR, TIRANË	VNM-PARAPRAKE
7	MATERIA CONS.AL	VNM-P GODINE BANIMI 6-8 KATËSH, VNM-P OBJEKTE SHËRBIMI SHKOLLE	TIRANË	REFUZIM
8	KOMUNA KASTART	MJEDISORE	SHKODRË	REFUZIM
9	2 AT	VNM-P MAGAZINË KIMIKATESH	BULGAREC, KORCE	REFUZIM
10	XHULIO	VNM TH- SHFRYTËZIMI I GURIT GËLQEROR VNM P- SHESH INDUSTRIAL PËR PËRFITIM I	OBJEKTI ABAZAJ, DURRËS	DEKLARATË MJEDISORE
11	BREMA AMBIENT	MATERIALEVE HEKUR/JOHEKUR	RRASHBULL, DURRËS	VNM-PARAPRAKE
12	INERTE EXPRES	VNM TH- SHFRYTËZIM I TRAVERTINAVE	FIERZË, ELBASAN	DEKLARATË MJEDISORE

## MINISTRIA E MJEDISIT- BILANCI I PUNËS NË KËTË VIT KALENDARIK

(vijon nga faqja e 1)

Kështu, kemi rishikimin e funksioneve të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, dhe krijimin për herë të parë të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave, si institucion më vete, me buxhet dhe infrastrukturë të pavarur, e shtrirje në të gjithë vendin, përmes zyrave rajonale.

AKM mori përsipër të gjithë autoritetin që i jep Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, në lidhje me Lejet Mjedisore dhe VNM, si edhe bën ndarjen e funksioneve monitoruese nga ato inspektuese, dhe krijon një rrjet të vetin kombëtar të zyrave mjedisore rajonale.

Në fushën e Menaxhimit të Mbetjeve janë hartuar 6 akte nënligjore, që rrjedhin nga ligji 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", duke bërë më të plotë kuadrin ligjor shqiptar dhe në përputhje me legjislacionin europian. Janë hartuar 7 plane rajonale të menaxhimit të mbetjeve, me asistencën e BE-së. U përfundua studimi i fizibilitetit për ngritjen e Impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit, projekt që pritet të fillojë në vitin 2015, me vlerë totale 20 milionë euro, si një projekt partneriteti publik - privat.

Në kuadër të ngritjes dhe forcimit të ka-

paciteteve në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, janë realizuar 12 trajnime, në 12 rajonet e vendit, me përfaqësuesit e Njësive të Qeverisjes Vendore.

Gjatë vitit 2014, në fushën e Cilësisë së Ajrit, ka pasur përmirësime të kuadrin ligjor, është miratuar VKM nr 594, datë 10.09.2014 " Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të Mjedisit" dhe Ligji Nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis".

Gjithashtu është në proces miratimi projektvendimi "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të".

Në fushën e Standarteve Mjedisore janë miratuar dhe janë në proces miratimi 7 akte ligjore për përafrimin e legjislacionit me BE-në në këtë fushë, ku mund të përmendim projekt-VKM-në "Për procedurën dhe kërkesat për pajisjen me ekoetiketen EU ECOLABEL" është një ndër aktet legislative që pritet të sjellë një risi në standartet mjedisore dhe zbatimin e tyre në vend.

Në kuadër të ngritjes dhe forcimit të kapaciteteve, janë realizuar disa dhjetëra trajnime në të gjithë vendin me përfaqësues të njësive të qeverisjes vendore për procesin e VNM-së, për

bashkëpunimin ndërkufitar dhe zbatimin e Konventës së ESPOOs dhe protokollit të Kievit, apo trajnime me Agjencitë Rajonale Mjedisore dhe ato të Inspektoratit Mjedisor për procedurat e VNM-së, lejeve të mjedisit dhe legjislacionin e ri të miratuar për këto fusha.


Në fushën e Informimit Mjedisor dhe Pjesëmarrjes së Publikut në Vendimmarrje, për herë të parë është hartuar Programi Kombëtar për Edukimin Mjedisor në shkollat nëntë-vjeçare, i cili pritet të miratohet edhe nga Ministria e Arsimit në fillim të 2015.

Përveç përgatitjes së 12 Buletineve të përmuajshme Mjedisore, të cilat dërgohen tek disa qindra adrese elektronike në mënyrë të rregullt, që nga Prilli 2014 janë përgatitur për herë të parë edhe Buletinet Javore.

Janë zhvilluar 12 trajnime me autoritetet e qeverisjes vendore dhe zyrat rajonale të mjedisit për konsultimin e publikut në vendimmarrjen mjedisore dhe zbatimin e Konventës së Aarhusit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E MJEDISIT



**THËNIA E MUAJIT**  
 “ ....vetëm me një gjethe  
 di të flas për pyllin... ” \*  
*Visar Zhiti*  
 Marrë nga “Molla e dënuar” – Poezi të zgjedhura

**SEKTORI I TRANSPARENÇES DHE KOMUNIKIMIT**  
 Email: info@moe.gov.al

**NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE**



**POLICIMI NË KOMUNITET**  
 Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim (Qendra EPER) me mbështetjen

financiare të Qeverisë Suedeze në kuadër të programit "Policimi në Komunitet" po organizon takime komunitare me banorët e Njërive Bashkiake, në Tiranë.

Takimet komunitare udhëhiqen nga të rinjtë e gjimnazëve të ndryshme të Tiranës në bashkëpunim me punonjësit e policisë së Komisarariateve të qytetit të Tiranës.

Ky aktivitet ka për qëllim informimin e publikut në veçanti të të rinjve mbi problematikat mjedisore në Tiranë dhe mbështetjen tek Policia e Shtetit si një partner për parandalimin e krimeve mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit. Këto takime po shërbejnë për rritjen e komunikimit të komunitetit me strukturat e policisë për kundrvajtjet mjedisore.



**LËVIZJA  
 "TA PASTROJMË  
 SHQIPËRINË"**

Kjo Shoqatë rinore vullnetare ka filluar të iniciojë nismën "TI MBROJMË PEMËT" në të gjithë Vendin. Fillimi i kësaj nisme ishte mbjellja e pemëve në zonën e Sharrës, një zonë mjaft

problematike kjo për qytetin e Tiranës. Kësaj iniciative rinore ju bashkuan shumë gjimnazistë të kryeqytetit dhe pse që një ditë me shi mbjellja vijoi sipas parashikimeve. Më pas do jetë qyteti i Rubikut që do vijohet me mbjellje. Kjo shoqatë vullnetare tashmë e njohur në të gjithë Shqipërinë për nismat e ndërrmarra në fushën e Mjedisit, nëpërmejt rrjeteve sociale ju ka bërë thirrje të gjithë shqiptarëve. Motoja e kësaj inisistive është "Nëse e ndjen vetën borxhli ndaj mjedisit eja bëhu pjesë e kësaj nisme në qytetin tënd, në shkollën tënde, në shtëpinë tënde."



**NDERGJEGJESIMI QYTETAR PER NDARJEN E DIFERENCUAR DHE RICIKLIMIN E MBETJEVE URBANE**

Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë me mbështetjen dhe bashkëpunimin e REC Albania, programi SENiOR-A, në kuadër të projektit "Ndërgjegjësimi qytetar për ndarjen e diferencuar dhe riciklimin e mbetjeve urbane", organizoi në datën 21.01.2015 , një sesion ndërgjegjësimi me nxënës të shkollës greke, Himarë - Omiros.

Qëllimi i këtij takimi ishte ndërgjegjësimi i nxënësve për ndarjen e diferencuar dhe riciklimin si dhe për rolin që duhet të luajnë të rinjtë, jo vetëm në këtë proces, por edhe në ndërgjegjësimin e të tjerëve për mbrojtjen e mjedisit. Në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësues të

organizatës partnere "EMMAUS VLORA", e cila do të bëjë tërheqjen e mbetjeve të riciklueshme dhe dërgimin e tyre në destinacion për t'i përdorur këto mbetje të riciklueshme për lëndë të parë për prodhimin e materialeve të reja, duke kursyer kështu lëndën e parë, energji dhe fuqi punëtore.

Gjithashtu pranë shkollave të mesme, 9-vjeçare dhe shkollës greke në Himarë, u vendosën koshat përkatës për ndarjen e ricikluar të qelqit, plastikës dhe metaleve.

Riciklimi është procesi i ripërpunimit të mbeturinave, i cili i vjen në ndihmë planetit tonë në forma të ndryshme, si kursim i lëndës së parë, mbajtja pastër e mjedisit etj.

Grumbullimi i mbetjeve bën të mundur një mjedis më të pastër për të gjithë, ndërsa riciklimi i tyre mbron burimet e pasuritë natyrore që të mos shterojnë.

Te gjithë ne, mund të ndikojmë e të luajmë një rol në procesin e riciklimit dhe ndarjes së diferencuar. Për të munduruar një ndarje të diferencuar sa më efektive, është i rëndësishëm bashkëpunimi midis të rinjve, institucioneve publike, komunitetit, shoqërisë civile dhe biznesit privat, me qëllim krijimin e një modeli pozitiv për të gjithë shoqërinë tonë.

